



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:279774

Datë: 13.11.2020

Numri i dokumentit: 01269573

P.nr . 1083/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE – Departamenti i Përgjithshëm NË PEJË, gjyqtari Ahmet Rexhaj , me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lindmire Begolli , në lëndën penale kundër të pandehurit B. H.nga ..... , për vepër penale : Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par 1 te KPRK-së , sipas aktakuzës të PPK në Pejë, PP/ II .nr.2708/19 duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor, PP/ II .nr. 2708/19 , me dt. 12.11.2020 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Pejë PP/ II.nr 2708/19 të dt. 26.11.2019 dhe kjo gjykatë pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor jep URDHËR NDËSHKIMOR.

I pandehuri

1. B. H. i lindur me ..... ne .... , ku tani banon ne Peje rr ..... pa nr pronar .....” ne rr..... , i biri R. e nenes F. e gjinis A., me nr pers..... , i martuar , i shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës

Ë S H T Ë FAJTOR

Për arsye se:

Me pare ne kohe te panjohur ne vazhdimësi e gjer me dt 15.11.2019 ne rr ..... nr .., ne ..... pikërisht ne objektin afarist te tij , me ane te mënyrave te tjera siguron shërbim te ujit për te cilin dihet qe sigurohet vetëm me shkëmbim te kompensimit dhe shmang pagesën per shërbim te tille ne vlere prej 680.40 euro ne atë mënyrë qe duke përdorur gypa te profilit 2 pa ore matëse krçet direkt ne rrjetin shpërndarës te ujit a autorizimin e H..... kështu duke i shkaktuar dem këtëj te fundit ne vlerën e shumes se shmangur,

Me qka ka bere vepër penale : Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par 1 te KPRK-së ,

Andaj gjykata konform nenit 38.39, 40,43 dhe nenit 314 par 1 1 te KPRk-së të pandehurit i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit B. H. i përcakton dënimin me gjobë në lartësi prej 300 ( treqinde ) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të aktgjykimit.

Nëse i pandehurit dënimin e përcaktuar nuk e paguan në afatin e caktuar , dënim me gjobë do ti zëvendësohet me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgu - 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, si dhe 30(tridhjetë) euro , në emër te taksës për kompensimin e viktimave , konform nenit 39 paragrafi 3 nen paragrafin 3.1 te ligjit 05/-L-036 në afatin prej 8 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore –juridike udhëzohet në kontestin civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë –Departamenti për krime te përgjithshme , kundër të pandehurit B. H. nga ..... ka ngritur aktakuzë PP-/II-nr. 2708/19 të dt. 26.11.2019 për veprë penale : : Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par 1 te KPRK-së ,

Konform nenit 493 të KPRK-së , Prokuroria Themelore në Pejë, pas ngritjes së aktakuzës kërkuar që gjykata pa mbajtur shqyrtim fillestar të jep urdhër ndëshkimor me të cilin te pandehurit ti shqiptohet dënim me gjobë.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 495 të KPRK gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPRK dhe pa e mbajtur shqyrtimin fillestar vendosi që ta pranoi kërkesën e Prokuroria Themelore në Pejë, për dhënjen e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptohet ndaj të pandehurit dënimi me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura shkresave të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri është kryes i veprës penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit të dënimit gjykata e vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 73 të KPK ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç rast si rethana lehtësuese gjykata vlerësoi të dhënat se i pandehuri më parë nuk kanë qenë i dënuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale. Rrethana rënduese për të pandehurin për momentin nuk kanë gjetur, prandaj , gjykata të pandehurin e dënoi si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje te plotë se ky dënim është adekuat me shkallën dhe rrezikshmerinë e veprës penale por edhe me shkallën e përgjegjësisë penale duke qenë e bindur se edhe me këtë dënim , ndaj tij mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPK.

Vendimi lidhur me kërkesën pronësore-juridike është marrë konform nenit 463 të KPPK .

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,DEPERTAMENTI I PËRGJITHSHEM**  
**P.nr 1083/19 te dt 12.11.2020**

Sekretare Juridike  
Lindmire Begolli

G j y q t a r i,  
Ahmet Rexhaj

**UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri  
Ka të drejtë të ushtrojë kundërshtim  
në afat prej 8 ditësh, të njëjtës gjykatë.